



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 194, Datë 22.09.2021

MBI

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË FTL SH.A., PËR SHTYRJEN E HYRJES NË FUQI TË VENDIMIT TË BORDIT TË ERE NR. 202, DATË 02.12.2020, PËR MIRATIMIN E “RREGULLORES PËR PROCEDURAT E SHITJES SË TEPRICAVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE NË TREGUN E PARREGULLUAR PËR SHOQËRINË PUBLIKE TË FURNIZIMIT”**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 19, të Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 104, pika 3, të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; nenit 11, pikat 2 dhe 3, të Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 244, datë 30.03.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar dhe nenit 15, të Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE në mbledhjen e tij të datës 22.09.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 122/4 prot., datë 20.09.2021, të Drejtorisë së Monitorimit të Tregut dhe Inspektimeve,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 202, datë 02.12.2020, vendosi miratimin e “Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar për shoqërinë publike të furnizimit”.
- Me vendimin nr. 156, datë 30.06.2021, bordi i ERE-s vendosi:
  - Pranimin e kërkesës për shtyrjen e datës së hyrjes në fuqi të Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar për shoqërinë publike të furnizimit, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 202, datë 02.12.2020.
  - Afati i hyrjes në fuqi të Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar për shoqërinë publike të furnizimit, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 202, datë 02.12.2020, shtyhet deri më 15 Shtator 2021.
  - Për periudhën tranzitore, të përcaktuar në pikën 2, të këtij vendimi, FTL sh.a., për qëllim të procedurës së shitjes së tepricave të energjisë elektrike, të përdorë “Rregullat e

*përgjithshme të organizimit të aktivitetit tregtar nga Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a.*, të miratuar me vendimin nr. 5233/1, datë 12.06.2019, të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit.

- *FTL sh.a.*, të raportojë në ERE çdo 30 ditë për ecurinë e implementimit dhe përshtatjen e platformës IT.

- *FTL sh.a.*, të përgatisë strategjinë/metodologjinë për mënyrën e realizimit të shitjes së tepricave të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, siç përcaktuar në nenin 13, pika 1, të Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar për shoqërinë publike të furnizimit në tregun e lirë, *FTL sh.a.*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 202, datë 02.12.2020, deri më 15 Shtator 2021.

- Shoqëria (FTL sh.a.) nëpërmjet shkresës nr. 1829/2 prot., datë 31.08.2021 me lëndë: “Vijim komunikimi mbi platformën IT online të shitjes së energjisë elektrike” dhe shkresës nr. 2593/1 prot., datë 09.09.2021, protokolluar në ERE me nr. 941 prot., datë 13.09.2021 ka bërë me dije se: “... se procedura e prokurimit me objekt “Mbi ndryshimet/zhvillimet në platformën IT online të blerjes së energjisë elektrike”, nga data 29.06.2021 është në proces ankimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”
- Së fundmi FTL sh.a., përmes shkresës nr. 1829/3 prot., datë 14.09.2021, protokolluar në ERE me nr. 945 prot., datë 14.09.2021, me lëndë “Mbi zbatimin e vendimit të ERE nr. 156, datë 30.06.2021”, ka bërë me dije se: “Për procedurën e prokurimit me objekt “Mbi ndryshimet/zhvillimet në platformën IT online të blerjes së energjisë elektrike”, Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin nr. 579, datë 08.09.2021, ka vendosur të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik. Në zbatim të këtij vendimi, Autoriteti Kontraktor do të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit, bazuar në përcaktimet e Ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”. Shoqëria FTL sh.a., ka marrë masat për hartimin e strategjisë/metodologjisë për mënyrën e realizimit të shitjes së tepricave të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, strategji e cila është në proces vlerësimi nga organet kompetente vendimmarrëse të shoqërisë”.
- Si dhe bërë me dije përmes shkresave të përcjella edhe më herët në ERE nga ana e FTL sh.a., rezulton se shoqëria ka ndërmarrë hapa për realizimin e ndryshimit/zhvillimit të nevojshëm në platformën IT online të blerjes së energjisë, me qëllim përdorimin e saj edhe për procedurat e shitjes së energjisë elektrike, por këto procese po zgjasin në kohë për arsye që nuk varen vetëm nga FTL sh.a.
- ERE vlerëson se shtyrja e datës së hyrjes në fuqi të Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar për shoqërinë publike të furnizimit, deri më 1 Dhjetor 2021, do të krijonte mundësi që shoqëria FTL sh.a., të realizojë ndryshimet e nevojshme në platformën IT online të blerjes së energjisë elektrike me qëllim përdorimin e kësaj platforme edhe në procedurat e shitjes së tepricave të

energjisë elektrike në tregun e parregulluar. Afati deri më 1 Dhjetor 2021 është vlerësuar i arsyeshëm nga ana e ERE, referuar dhe sa kërkuar në shkresën e FTL sh.a., nr. 1829/1 prot., datë 21.06.2021, protokolluar në ERE me nr. 104/10 prot., datë 22.06.2021 në të cilën shoqëria sqaron se: *“Përsa i përket ndryshimeve/zhvillimeve në platformën IT online të shitjes së energjisë elektrike, aktualisht procedura e prokurimit publik është në fazën e vlerësimit të ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës. Implementimi i platformës IT online të shitjes së energjisë elektrike, do të realizohet në një afat 65 (gjashtëdhjetë e pesë) ditë nga data e lidhjes së kontratës së shërbimit me operatorin ekonomik fitues, të kësaj procedure prokurimi”*. Nisja e llogaritjes së afatit është bërë nga data 08.09.2021, siç bërë me dije nga ana e FTL sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 1829/3 prot., datë 14.09.2021, protokolluar në ERE me nr.945 prot, datë 14.09.2021, me lëndë: *“Mbi zbatimin e vendimit të ERE nr. 156, date 30.06.2021”*, ku ndër të tjera informohet se: *Për procedurën e prokurimit me objekt “Mbi ndryshimet/zhvillimet ne platformen IT online të blerjes së energjisë elektrike”, Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin Nr. 579, datë 08.09.2021, ka vendosur të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik. Në zbatim të këtij vendimi, Autoriteti Kontraktor do të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit, bazuar në përcaktimet e ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, duke evituar edhe ndërhyrjen në procedurat e organeve të tjera.*

- Tepricat e energjisë elektrike të cilat do të tregtohen nga FTL sh.a. janë të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.03.2016, *“Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”*, i ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Pranimin e kërkesës për shtyrjen e datës së hyrjes në fuqi të *Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar për shoqërinë publike të furnizimit*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 202, datë 02.12.2020.
2. Afati i hyrjes në fuqi të *Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar për shoqërinë publike të furnizimit*, shtyhet deri më 1 Dhjetor 2021.
3. Për periudhën tranzitore, të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, FTL sh.a., për qëllim të procedurës së shitjes së tepricave të energjisë elektrike, të përdorë *“Rregullat e përgjithshme të organizimit të aktivitetit tregtar nga Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a.”*, të miratuar me vendimin nr. 5233/1, datë 12.06.2019, të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit.

4. FTL sh.a., të marrë masa për implementimin në kohë të ndryshimeve në platformën IT, si dhe të raportojë në ERE çdo 30 ditë për ecurinë e implementimit të platformës.
5. FTL sh.a., të përcjellë në ERE një kopje të strategjisë/metodologjinë për mënyrën e realizimit të shitjes së tepricave të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, siç përcaktuar në nenin 13, pika 1, të Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar për shoqërinë publike të furnizimit në tregun e lirë, FTL sh.a., miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 202, datë 02.12.2020, më 1 Dhjetor 2021.
6. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë shoqërinë FTL sh.a., dhe palët e interesit të përfshira në dhënien e opinionëve për draftin e *Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar për shoqërinë publike të furnizimit*, “Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES)”, për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**